

# **AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “ALBANIA NEW CARS” SH.P.K.**

Sot më datë 20 Gusht 2024, **Z. Ermal Elezi**, i datëlindjes 15.02.1995, banues në Tiranë shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** si më poshtë vijon:

## **1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria “**Albania New Cars**” **sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

## **2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Z. Ermal Elezi**.

## **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** do të jetë:

Sherbim tregtim automjeteve. Servis për automjete dhe lavazh. Dhenie me qera. Servis për riparime elektrike, mekanike, pjesë këmbimi, etj të automjeteve të të gjitha llojeve. Import-Export të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre. Sherbime të lidhura me fushat e mesipërme si edhe cdo aktivitet tjetër që nuk ndalohej nga ligji.

## **4. Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** do të jetë në: Rruga “Vaso Pasha”, Pallati 24, Hyrja 2, Ap.Nr.6, Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

4.1 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

## **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## **6. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** është 100.000 Lekë. (njqindmije)

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

## **7. Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** është **Z. Ermal Elezi**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**Albania New Cars**” **sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i nje ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## **8. Shpërbërja dhe likuidimi**

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm**

Ermal Elezi